

RAPORT I NDËRMJETËM
20 mars – 6 prill 2021

9 prill 2021

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

- Zgjedhjet parlamentare do të zhvillohen në kuadrin e një marrëveshjeje politike të arritur në qershor të vitit 2020, e cila u pasua me reformën zgjedhore. Zhvillimi i këtyre zgjedhjeve shihet gjerësisht si një provë për progresin demokratik të Shqipërisë në bisedimet për aderimin e vendit në Bashkimin Evropian. Megjithëse zgjedhjet e ardhshme ofrojnë një gamë gjithëpërfshirëse kandidatësh, nga të cilët votuesit mund të zgjedhin kandidatin që preferojnë, këto zgjedhje po zhvillohen në një atmosferë paqëndrueshmërie politike dhe mosbesimi të thellë mes partive kryesore politike.
- 140 anëtarët e Kuvendit zgjidhen për një mandat katër-vjeçar përmes një sistemi të përfaqësimit proporcional rajonal të modifikuar së fundmi, ku zgjedhësit mund të votojnë për kandidatët e tyre të preferuar në të 12 qarqet nga listat shumë-emërore të kandidatëve. Për t'u kualifikuar për marrjen e një mandati në parlament, kandidatët në këto zgjedhje duhet të kalojnë pragun prej një përqind në shkallë vendi.
- Kuadri ligjor është ndryshuar ndjeshëm në vitin 2020, në vijim të një marrëveshjeje politike të mëparshme. Ajo çka është e rëndësishme është që këto ndryshime kanë prekur, ndër të tjera, edhe strukturën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), kanë futur identifikimin elektronik të zgjedhësve në ditën e zgjedhjeve dhe kanë parashikuar edhe disa garanci rregullatore shtesë kundër shpërdorimit të burimeve publike. Ndryshimet kanë prekur, gjithashtu, edhe fushën e financimit publik dhe privat të fushatës, mbikëqyrjen e mbulimit mediatik të fushatës, si dhe mekanizmin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve zgjedhore. Në tetor, Kodi Zgjedhor iu nënshtrua një rishikimi të mëtejshëm dhe u bë objekt kritikash për mungesën e konsultimeve dhe për miratimin e tij të nxituar.
- Tashmë po zhvillohen përgatitjet për zgjedhjet. KQZ-ja e sapoformuar ka rregulluar aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor që tashmë janë në proces e sipër dhe ka përballuar një ngarkesë ndjeshëm më të madhe pune brenda një afati të shkurtër kohe. Disa bashkëbisedues të Misionit të Kufizuar për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MKVZ) të ODIHR-it kanë shprehur shqetësime për kohën e kufizuar të përgatitjes para ditës së zgjedhjeve. KQZ-ja ka ngritur 92 Komisione të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), të cilat do të duhet të ngrenë rreth 5,200 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV). Votimi dhe numërimi elektronik i votave do të pilotohen në një pjesë të qarkut të Tiranës. Pritet ende të nisë një program mbarëkombëtar i edukimit të zgjedhësve për adresimin e mundësisë së re të votimit preferencial, si dhe për sistemin e sapofutur në përdorim për regjistrimin elektronik të zgjedhësve.
- Për herë të parë, në të gjitha qendrat e votimit, do të futet një sistem elektronik i regjistrimit të votuesve në ditën e zgjedhjeve. Shumica e bashkëbiseduesve të MKVZ-së së ODIHR-it kanë shprehur vlerësime për këtë sistem, të cilin ata e perceptojnë si një masë për minimizimin e rrezikut të votimit të dyfishtë apo të falsifikimit të identitetit të zgjedhësit. Deri më 15 mars, lista e zgjedhësve përbëhej nga rreth 3.5 milion zgjedhës, duke përfshirë edhe ata që jetojnë jashtë vendit.

- Në këto zgjedhje mund të garojnë kandidatë të emëruar nga parti politike, koalicione partish ose kandidatë të pavarur që emërohen nga grupe zgjedhësish. Krerët e partive mund të garojnë në deri katër qarqe, ndërsa të gjithë kandidatët e tjerë mund të garojnë vetëm në një qark. KQZ-ja ka regjistruar gjithsej dymbëdhjetë lista garuese në të gjithë vendin dhe pesë kandidatë të pavarur që garojnë në pesë qarqe.
- Dy partitë e mëdha e nisën fushatën më 25 mars. Fushata u hap në kushtet e kufizimeve të vendosura si rrjedhojë e pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, të cilat përfshijnë edhe kufizimin e grumbullimeve dhe ruajtjen e distancës personale. Partitë kryesore synojnë ta organizojnë fushatën përmes kontakteve derë-më-derë, si përmes qasjes tradicionale, ashtu edhe asaj të mediave sociale. Në fillimet e saj, kjo fushatë u karakterizua nga një ton jo i moderuar dhe nga akuza për korrupsion dhe për lidhje me krimin e organizuar. KQZ-ja u ka bërë thirrje të gjitha subjekteve zgjedhore të tregojnë vetëpërbajtje, të ruajnë qetësinë dhe të mos përdorin gjuhë të ashpër gjatë fushatës.
- Mjedisi mediatik në Shqipëri është i larmishëm dhe me një numër të madh organesh mediatike, por perceptohet gjerësisht si i rreshtuar politikisht. Ka rregulla të hollësishme për mbulimin mediatik të fushatës që parashikojnë kohë televizive falas në Radio Televizionin Publik dhe reklama politike me pagesë në mediat private për të gjitha subjektet zgjedhore. Legjislacioni ende e lejon përdorimin e përbajtjeve mediatike të prodhuara nga vetë partitë në programet e lajmeve, me kushtin që ato të identifikohen qartësisht si të tilla.
- Sa i përket financimit të fushatës, ligji përcakton disa limite për dhurimet dhe shpenzimet. KQZ-ja mbikëqyr respektimin e rregullave për financimin e fushatës dhe është e autorizuar të vendosë sanksione. Përveç kësaj, KQZ-ja është gjithashtu e autorizuar të monitorojë të gjitha aktivitetet e kryera nga institucionet publike për të parë nëse ka shpërdorim të burimeve publike. Ligji nuk parashikon ndonjë detyrim për bërjen publike të burimit dhe shumës së fondeve të mbledhura. Përveç kësaj, partive politike as nuk u kërkohet të bëjnë raportime të ndërmjetme gjatë fushatës. Ligji gjithashtu parashikon fonde publike për partitë, por jo për kandidatët e pavarur.
- Sipas ligjit, vetëm partitë politike dhe kandidatët e pavarur, të cilëve u janë prekur të drejtat, kanë të drejtë të paraqesin ankesa kundër organeve të administrimit të zgjedhjeve. Deri më 5 prill, në KQZ janë paraqitur dhjetë ankesa që kanë të bëjnë kryesisht me regjistrimin e kandidatëve, shpërdorimin e burimeve të administratës publike dhe me konfigurimin e fletës së votimit. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor ka gjykuar tre ankime ndaj vendimeve të KQZ-së, nga të cilat dy i përkisnin regjistrimit të kandidatëve, kurse tjetri konfigurimit të fletës së votimit.
- Ligji parashikon vëzhgimin e zgjedhjeve nga vëzhgues vendorë dhe ndërkombëtarë. Në vëzhgimin e zgjedhjeve mund të marrin gjithashtu pjesë përfaqësuesit e partive dhe të kandidatëve të pavarur. Deri më 3 prill, KQZ-ja ka regjistruar tetë grupe vëzhguesish vendorë.

II. PARATHËNIE

Në përgjigje të ftesës së Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për të vëzhguar zgjedhjet parlamentare të 25 prillit dhe bazuar në rekomandimet e Misionit të Vlerësimit të Nevojave, zhvilluar nga data 25 deri më 28 janar, Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR), ngriti me 18 mars një Mision të Kufizuar për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MKVZ).¹ I kryesuar nga Ambasadorja Urszula Gacek, MKVZ-ja e ODIHR-it përfshin 13 specialistë të vendosur

¹ Shih [të gjitha raportet e ODIHR-it në lidhje me zgjedhjet në Shqipëri](#).

në Tiranë dhe 24 vëzhgues afatgjatë të vendosur në të gjithë vendin që prej datës 26 mars. Anëtarët e misionit janë përzgjedhur nga 20 Shtete pjesëmarrëse të OSBE-së.²

III. KONTEKSTI

Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2017 pasuan me vijueshmërinë në pushtet të Partisë Socialiste të Shqipërisë (PS), me një shumicë mandatesh prej 74 nga 140 mandate gjithsej.³ Pas marrjes së mandateve, partitë e opozitës organizuan protesta në rrugë, duke kërkuar dorëheqjen e Kryeministrit Edi Rama dhe ngritjen e një qeverie të përkohshme dhe kur kërkesat e tyre nuk u plotësuan, pothuajse të 66 deputetët e opozitës hoqën dorë nga mandatet parlamentare në shkurt të vitit 2019. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) i plotësoi vendet e mbetura vakant, duke pasur tashmë nga njëra anë deputetë të opozitës të emëruar në parlament dhe, nga ana tjetër, një opozitë jashtë-parlamentare në kërkim të mbështetjes popullore dhe të vendosur për t'i shkuar deri në fund kauzës së saj jashtë parlamentit.⁴ Duke e thelluar edhe më tej këtë problematikë politike, zgjedhjet lokale të vitit 2019 u zhvilluan pa pjesëmarrjen e partive kryesore parlamentare të opozitës, duke çuar në një fitore masive të koalicionit Aleanca për Shqipërinë Evropiane të udhëhequr nga PS-ja.⁵

Përmes krijimit të një platforme ndërpartiake për negociatë, e njohur si “Këshilli Politik”, PS-ja dhe opozita parlamentare dhe ajo jashtë-parlamentare i dhanë fund ngërçit politik përmes një marrëveshjeje të arritur në qershor të vitit 2020 për ndryshime në ligjin zgjedhor dhe në strukturën e administratës zgjedhore. Kjo marrëveshje i hapi rrugën kthimit të opozitës në procesin zgjedhor.

Në mars të vitit 2020, Këshilli i Bashkimit Evropian hapi negociatat për anëtarësimin e Shqipërisë në BE. Megjithatë, BE-ja e kushtëzoi edhe më tej procesin e anëtarësimit, duke i kërkuar Shqipërisë realizimin e reformave të mëtejshme institucionale, duke përfshirë edhe zbatimin e rekomandimeve të ODIHR-it për zgjedhjet para se Shqipërisë t'i jepet e drejta për Konferencën e saj të parë Ndërqeveritare, e cila konsiderohet si një hap kyç për vazhdimin e procesit.⁶ Zhvillimi i këtyre zgjedhjeve shihet gjerësisht si provë për progresin demokratik të Shqipërisë në bisedimet për aderimin e vendit në Bashkimin Evropian.

Një tjetër kërkesë themelore e vendosur nga Këshilli ishte edhe vazhdimi i reformës në drejtësi, duke përfshirë edhe garantimin e funksionimit të Gjykatës Kushtetuese.⁷ Ndonëse reforma në drejtësi ka

² Në raportin e Misionit të Vlerësimit të Nevojave, ODIHR-i rekomandoi dërgimin e një Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ) i cili, përveç ekipit kryesor të analistëve, do të përfshinte edhe 24 vëzhgues afatgjatë dhe 250 vëzhgues afatshkurtër për të vëzhguar procedurat në ditën e zgjedhjeve. Sidoqoftë, për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme të shkaktuara nga pandemia e COVID-19 dhe kufizimet ekzistuese të udhëtimit në të gjithë zonën e OSBE-së, ODIHR-i ndryshoi formatin e aktivitetit të vëzhgimit nga MVZ në MKVZ. Në përputhje me metodën standarde të ODIHR-it për MKVZ-të, ky mision nuk do të bëjë vëzhgime gjithëpërfshirëse apo sistematike të procedurave në ditën e zgjedhjeve, por planifikon të vizitojë një numër të caktuar qendrash votimi.

³ Rezultati i zgjedhjeve parlamentare 2017: Partia Socialiste (PS) - 74; Partia Demokratike (PD) - 43; Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) - 19; Partia Drejtësi, Integritet dhe Unitet (PDIU) - 3; Partia Social Demokrate (PSD) - 1.

⁴ Ish-deputetët e partive opozitare dhe liderët politikë të partive opozitare nuk e pranuan legjitimitetin e deputetëve me të cilët u zëvendësuan.

⁵ Në garën për 61 bashkitë, koalicioni i udhëhequr nga PS-ja fitoi 60 bashki, kurse Partia Minoritetit Etnik Grek për të Ardhmen, fitoi një bashki. Në këto zgjedhje vendore, koalicioni fitues mori më shumë se 94 për qind të votave, d.m.th. 1,555 nga 1,619 vende gjithsej.

⁶ [Këshilli i Bashkimit Evropian vendosi](#) që “[...] Shqipëria duhet të miratojë reformën zgjedhore plotësisht sipas rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it, duke siguruar transparencë mbi financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore, [...]”.

⁷ Gjykata Kushtetuese, juridiksioni i së cilës përfshin gjykimin e shkëljes së të drejtave dhe lirive kushtetuese, e ka për momentin një kuorum gjyqtarësh të emëruar. Emërimet e tjera të pritshme në Gjykatën Kushtetuese mund të bëhen vetëm pasi Gjykata e Lartë, si autoriteti i tretë emëruar pas Parlamentit dhe Presidentit të Republikës, të ketë arritur kuorumin e vet minimal të gjyqtarëve.

vazhduar të rezultojë në një progres të mirë, duke përfshirë edhe në procesin e vetingut gjyqësor, tentativat për ndërhyrje në gjyqësor, duke përfshirë edhe tentativat nga autoritetet brenda gjyqësorit, si dhe presioni i brendshëm dhe i jashtëm ndaj prokurorëve vazhdon të mbetet çështje shqetësuese.⁸ Disa prej bashkëbiseduesve të Misionit të Kufizuar të Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MKVZ), duke përfshirë edhe disa parti politike të opozitës, shprehën shqetësime të vazhdueshme në lidhje me pavarësinë e gjyqësorit, të bazuara, ndër të tjera, në integritetin e vetë procesit të vetingut të gjyqësorit dhe me ndikimin që ky proces mund të ketë në zgjidhjen e paanshme të mosmarrëveshjeve zgjedhore.

Presidenti Ilir Meta shpalli më 6 shtator 2020 mbajtjen e zgjedhjeve parlamentare më 25 prill 2021. PS-ja dhe LSI-ja garojnë në këto zgjedhje si parti individuale. PD-ja kryeson një koalicion prej 13 partish, duke përfshirë edhe PDIU-në. Këto zgjedhje i japin zgjedhësit mundësi për të zgjedhur kandidatin e preferuar, por zhvillohen në një atmosferë mosbesimi të thellë dhe pasigurie politike.

IV. KUADRI LIGJOR DHE SISTEMI ZGJEDHOR

Kuadri ligjor përbëhet nga Kushtetuta e vitit 1998, Kodi Zgjedhor i vitit 2008 dhe ligjet e tjera relevante.⁹ Shqipëria është palë në instrumentet kryesore juridike ndërkombëtare në lidhje me zgjedhjet.¹⁰

Pas një procesi të hapur, gjithëpërfshirës dhe të plotë, më 23 korrik, Parlamenti miratoi një sërë ndryshimesh në Kodin Zgjedhor.¹¹ Ajo çka është më e rëndësishmja është që këto ndryshime forcojnë garancitë për ekuilibrin gjinor në listat e kandidatëve dhe parashikuan garanci shtesë ndaj shpërdorimit të burimeve publike, duke adresuar rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it. Këto ndryshime në Kodin Zgjedhor prekën edhe strukturën e KQZ-së dhe procedurën e verifikimit të emërimit të kandidatëve, financimin publik dhe privat të fushatës, mbikëqyrjen e mbulimit të fushatës në media, si dhe mekanizmin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve zgjedhore.¹²

Më 30 korrik, me ndryshimet kushtetuese hyri në përdorim votimi preferencial, pasuar me ndryshime në Kodin Zgjedhor më 5 tetor, që bënë rregullimin e detajuar të disa procedurave zgjedhore. Në Opinionin e tyre të Përbashkët, Komisioni i Venecias i Këshillit të Evropës dhe ODIHR-i shprehën keqardhje për procedurat “jashtëzakonisht të nxituara” të miratimit të ndryshimeve në Kushtetutë dhe në Kodin Zgjedhor, të cilat nuk u paraprinë nga një proces i duhur konsultimi, ndryshe nga “diskutimet e hapura, gjithëpërfshirëse dhe të plota” që u paraprinë ndryshimeve të 23 korrikut.¹³ Edhe partitë

⁸ Referoju [Raportit të Progresit të Komisionit Evropian të vitit 2020](#) për Shqipërinë. Shih gjithashtu edhe [Deklaratën e Përbashkët për Shtyp pas takimit të 11 të Këshillit të Stabilizim Asociimit mes BE-së dhe Shqipërisë të datës 1 mars 2021](#).

⁹ Përfshin Ligjin e vitit 2000 për Partitë Politike, Ligjin 2001 për Tubimet, Ligjin 2013 për Median Audio-Vizuale, Ligjin 2015 për Garantimin e Integritetit të Personave që Zgjidhen, Emërohen ose Ushtrijnë Funksione Publike (i ashtuquajtur Ligji i Dekriminalizimit), dhe Ligjin e vitit 2008 për Barazinë Gjinore

¹⁰ Këtu përfshihet Marrëveshja Ndërkombëtare e vitit 1966 për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventa Ndërkombëtare e vitit 1965 për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial, Konventa e vitit 1979 të OKB-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, Konventa e vitit 2003 të OKB-së kundër Korrupsionit, Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara të vitit 2006, si dhe Konventa Evropiane e vitit 1950 për të Drejtat e Njeriut. Shqipëria është anëtare e Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës dhe Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO).

¹¹ Procesi përfshiu edhe disa ekspertë të shoqërisë civile, parti të vogla politike dhe komunitetin ndërkombëtar. Shih [paragrafin 33 të Opinionit të Përbashkët të Komisionit të Venecias dhe ODIHR-it](#) mbi ndryshimet në Kushtetutë të datës 30 korrik 2020 dhe në Kodin Zgjedhor të datës 5 tetor 2020.

¹² Reforma parashikoi gjithashtu edhe identifikimin elektronik të zgjedhësve në ditën e zgjedhjeve, pilotimin e mundësisë së votimit nga jashtë vendit, pilotimin e votimit dhe numërimit elektronik të votave në një pjesë të një qarku dhe disa ndryshime të rregullave për caktimin e ditës së zgjedhjeve.

¹³ [See 2020 Joint Opinion of the Venice Commission and ODIHR](#) mbi ndryshimet kushtetuese të 30 korrikut 2020 dhe ndryshimet në Kodin Zgjedhor të 5 tetorit 2020.

kryesore të opozitës e informuan MKVZ-në e ODIHR-it se mbeten të pakënaqura me përmbajtjen e këtyre ndryshimeve dhe me mënyrën e miratimit të tyre.

Parlamenti prej 140 anëtarësh zgjidhet për një mandat katër-vjeçar përmes një sistemi proporcional rajonal. Kandidatët zgjidhen nga 12 zona zgjedhore që përkrijnë me qarqet administrative, përmes listave shumë-emërore të kandidatëve. Numri i mandateve që i takon secilit qark varet nga numri i shtetasve të regjistruar në të.¹⁴ Votimi preferencial brenda listave të partive, i futur me ndryshimet e fundit, i jep mundësi zgjedhësit që të ndikojë në renditjen e kandidatëve në listë.

Për t'u kualifikuar për marrjen e një mandati në parlament, subjektet zgjedhore, duke përfshirë edhe kandidatët e pavarur, duhet të kalojnë pragun prej një përqind në shkallë vendi. Ndonëse ligji është i qartë për zbatueshmërinë e pragut prej një përqind në shkallë vendi për kandidatët e pavarur, KQZ-ja e informoi MKVZ-në e ODIHR-it se po shqyrton nëse do ta zbatojë apo jo këtë prag në rastin e tyre.

V. ADMINISTRATA ZGJEDHORE

Administrata zgjedhore përbëhet nga KQZ-ja, 92 Komisione të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), dhe rreth 5,200 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV). Numërimi bëhet nga Grupet e Numërimit të Votave (GNV) në 92 Vende të Numërimit të Votave (VNV), një për secilën Zonë të Administrimit Zgjedhor (ZAZ).

Ndryshimet ligjore të vitit 2020 i ndryshuan rregullat e formimit të KQZ-së dhe futën tre degë të dallueshme në strukturën e saj: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (Komisioneri) ka autoritet të gjerë ekzekutiv. Ai drejton administratën dhe përfaqëson KQZ-në në marrëdhëniet me palët e treta, kurse Zëvendëskomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (Zëvendëskomisioneri) mbikëqyr teknologjinë e identifikimit të zgjedhësve, rekrutimin dhe trajnimin e zyrtarëve të zgjedhjeve. Komisioni Rregullator (Rregullatori) miraton akte normative nënligjore, siç parashikohet nga Kodi Zgjedhor. Komisioni i Ankesave dhe Sanksioneve (KAS) shqyrton ankesat kundër vendimeve të Komisionerit dhe KZAZ-ve, vendos për pavlefshmërinë e votimit dhe të rezultateve të zgjedhjeve dhe mund të vendosë sanksione për shkelje të Kodit Zgjedhor me kërkesë të Komisionerit. Të gjithë anëtarët e KQZ-së zgjidhen nga parlamenti me jo më pak se tre të pestat e votave.¹⁵ Tre nga 12 anëtarët e KQZ-së janë gra. Rregullatori dhe KAS-i kanë secili nga pesë anëtarë.

KQZ-ja filloi përgatitjet për zgjedhjet menjëherë pas formimit të saj në tetor të 2020-ës dhe që atëherë është përballur me një ngarkesë pune të rritur ndjeshëm, pjesërisht për shkak të futjes së identifikimit elektronik të votuesve dhe të një projekti pilot për votimin dhe numërimin elektronik. Disa bashkëbisedues të MKVZ-së së ODIHR-it kanë shprehur shqetësime për kohën e kufizuar të përgatitjes para ditës së zgjedhjeve. Sidoqoftë, KQZ-ja ka mbajtur sistematikisht seanca të hapura për mediat, vëzhguesit dhe për përfaqësuesit e partive/koalicioneve, dhe i ka transmetuar ato drejtpërdrejt në internet. Deri më sot, KQZ-ja ka miratuar një sërë rregulloresh dhe udhëzimesh në lidhje me aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor, duke përfshirë ngritjen e KQV-ve, caktimin e mandateve për zonë zgjedhore, si dhe financimin e fushatës. Vendimet e Rregullatorit dhe të Komisionerit janë publikuar në kohë në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së.

KZAZ-të, të emëruara nga KQZ-ja në muajin janar, përbëhen secila nga shtatë anëtarë dhe nga një sekretar pa të drejtë vote. Tre anëtarë të KZAZ-së emërohen nga shumica parlamentare (PS dhe PSD),

¹⁴ Më 11 dhjetor 2020, Komisioni Rregullator i KQZ-së vendosi për ndarjen e mandateve për qark për zgjedhjet e 2021-shit. Për shkak të demografisë, Tiranës iu caktuan dy vende në parlament, kurse Dibra dhe Gjirokastra humbën secila nga një vend krahasuar me zgjedhjet parlamentare të vitit 2017-ës.

¹⁵ Kohëzgjatja e mandateve të tyre varion: Komisioneri dhe Zëvendëskomisioneri zgjidhen përkatësisht për mandate shtatë dhe katër-vjeçare, kurse Rregullatori dhe CSC përkatësisht për mandate pesë dhe nëntë-vjeçare.

kurse tre të tjerë nga opozita parlamentare (PD dhe LSI).¹⁶ Përveç kësaj, PS-ja dhe PD-ja propozojnë anëtarin e shtatë si partitë kryesore në pushtet dhe në opozitë.¹⁷ Pavarësisht një rekomandimi të mëparshëm të ODIHR-it, partitë politike kanë ende të drejtën t'i tërheqin anëtarët që emërojnë sipas gjykimit të vet. KZAZ-të organizojnë zgjedhjet në ZAZ-të e tyre përkatëse, caktojnë anëtarët e KQV-ve dhe të GNV-ve, regjistrojnë informacionet ose pretendimet e marra nga subjektet zgjedhore në zonat përkatëse dhe nxjerrin rezultatet e zgjedhjeve. KQV-të emërohen duke përdorur një formulë të ngjashme me KZAZ-të. Anëtarët e KQV-ve janë përgjegjës për zhvillimin e zgjedhjeve në qendrat e votimit.¹⁸ Të katër anëtarët e Grupeve të Numërimit të Votave (GNV) duhet të emërohen 10 ditë para ditës së zgjedhjeve.

Vazhdojnë sesionet e trajnimit kaskadë për anëtarët e KZAZ-ve të organizuara nga KQZ-ja, ku moduli i parë i trajnimit mbulon rolet dhe përgjegjësitë e anëtarëve të KZAZ-ve dhe procedurat e votimit dhe përfundoi në mes të muajit mars, kurse moduli i dytë trajton procedurat e numërimit të votave dhe planifikohet të mbahet javën e fundit para ditës së zgjedhjeve së bashku me anëtarët e GNV-ve. Trajnimi i anëtarëve të KQV-ve planifikohet të fillojë që nga data 16 prill e në vijim.

KQZ-ja ka planifikuar një fushatë për edukimin e zgjedhësve në bashkëpunim me organizatat lokale dhe ndërkombëtare që synojnë të gjitha kategoritë e zgjedhësve, duke përfshirë zgjedhësit që votojnë për herë të parë dhe shtresat e cenushme. Temat përfshijnë identifikimin e ri elektronik të zgjedhësve dhe mundësinë e re që u jepet zgjedhësve për të shprehur preferencën e tyre në fletën e votimit. Shumë bashkëbisedues të MKVZ-së së ODIHR-it kanë shprehur shqetësimin se aktivitetet për edukimin si duhet të zgjedhësve janë tashmë të vonuara.

Votimi dhe numërimi elektronik i votave do të pilotohen në një nga ZAZ-të e qytetit të Tiranës. Kjo ZAZ e dedikuar përfshin 32 QV. Pajisjet e votimit përbëhen nga një modul me prekje dhe nga një printer i lidhur me gjurmët e kontrollit të letrës. Çdo QV ka dy grupe pajisjesh votimi në dispozicion të zgjedhësve. Procesi i prokurimit të kësaj zgjedhjeje të re u mbyll një muaj para ditës së zgjedhjeve, kurse konfigurimi i programit kompjuterik (software) është ende në proces.

VI. REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE

Çdo shtetas shqiptar, që ka mbushur moshën 18 vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve ka të drejtën e votës. Edhe pse kufizimi i të drejtës së votës për personat e shpallur me vendim gjykatë si të pazotë për të vepruar është hequr nga neni i Kodit Zgjedhor mbi kriteret për përfshirjen e zgjedhësit në listat e zgjedhësve, ai vazhdon të qëndrojë në nene të tjera (të Kodit) dhe në Kushtetutë.¹⁹ Shtetasit që janë duke kryer një dënim me burg për kryerjen e veprave të caktuara penale nuk mund të votojnë.²⁰ Megjithatë në Kodin Zgjedhor parashikohet tashmë votimi jashtë vendit, KQZ-ja nuk ka marrë deri tani asnjë vendim zyrtar për këtë çështje.

¹⁶ Shumica më e madhe parlamentare dhe partia më e madhe e opozitës propozojnë nga dy anëtarë të KZAZ-ve secila. Përveç kësaj, shumica e dytë parlamentare dhe partia e dytë opozitare propozojnë nga një anëtar secila.

¹⁷ Për këto zgjedhje, PD-ja dhe PS-ja kanë emëruar anëtarin e shtatë në 46 KZAZ secila.

¹⁸ Për çdo tryezë të numërimit të votave ka dy GNV. Çdo GNV numëron jo më pak se 5 dhe jo më shumë se 10 qendra votimi. Përbërja e një GNV-je bazohet në emërimet politike dhe synon garantimin e një ekipi të ekuilibruar politikisht.

¹⁹ Neni 45 i Kushtetutës parashikon që shtetasit e shpallur mendërisht të paafte nuk kanë të drejtën e votës. Neni 53 i Kodit Zgjedhor parashikon që listat e zgjedhësve janë objekt ndryshimesh që bazohen, ndër të tjera, në vendimet e gjykatës në lidhje me pazotësinë për të vepruar.

²⁰ Ligji i Dekriminalizimit u pezullon të drejtën e votimit shtetasve që po kryejnë një dënim me burg për kryerjen e veprave penale të renditura në më shumë se 80 nene të Kodit Penal (duke variuar nga shkeljet zgjedhore e deri tek krimet e rënda). Sipas Ministrisë së Brendshme, e drejta e votës u është pezulluar 1,098 të burgosurve.

Sistemi i regjistrimit të zgjedhësve është pasiv; sidoqoftë votuesit mbi moshën 100 vjeç hiqen automatikisht nga lista e zgjedhësve dhe duhet të konfirmojnë të dhënat e tyre për t'u futur sërish në lista.²¹ Listat e zgjedhësve mbështeten në bazën elektronike të të dhënave të Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile, e cila mirëmbahet nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC) pranë Ministrisë së Brendshme. Subjekteve zgjedhore në procesin zgjedhor u jepet një kopje e listës së zgjedhësve falas me kërkesë të tyre. Zyrat e Gjendjes Civile kanë publikuar çdo muaj ekstrakte të listës së zgjedhësve, duke filluar nga 3 tetori 2020 dhe i kanë vënë listat e zgjedhësve në dispozicion për shqyrtim publik. Në lista mund të bëheshin korrigjime deri në 40 ditë para zgjedhjeve. Zgjedhësit mund edhe t'i verifikojnë të dhënat e tyre *online* pas publikimit të listës përfundimtare. Deri më 15 mars, numri total i zgjedhësve të regjistruar ishte 3,588,869, duke përfshirë edhe zgjedhësit që jetojnë jashtë vendit.²²

KQZ-ja mbikqyr procesin e përpilimit të listës së zgjedhësve. Dy auditues, të emëruar nga KQZ-ja në tetor të 2020-ës për të vlerësuar saktësinë e listës së zgjedhësve, konstatuan probleme si: ndryshime të të dhënave të adresës së zgjedhësve pa u informuar këta të fundit, vonesa në dorëzimin e njoftimit të zgjedhësve në disa prej bashkive dhe zgjedhës që nuk jetojnë më të regjistruar në listën e zgjedhësve.²³

Zgjedhësit regjistrohen në listën e qendrës së votimit që mbulon vendbanimin e tyre. Ata mund të votojnë vetëm duke u paraqitur fizikisht në qendrën e votimit dhe jo me postë apo përmes kutive të lëvizshme të votimit, pasi këto të fundit nuk parashikohen me ligj.²⁴ Qendra të posaçme votimi mund të organizohen në burgje, në ambiente paraburgimi dhe në spitale; megjithatë, nuk ka ende një vendim përfundimtar nëse zgjedhësit që ndodhen në këto institucione do të kenë apo jo mundësi të votojnë.

Për herë të parë do të përdoret një sistem elektronik i regjistrimit të zgjedhësve në ditën e zgjedhjeve për të minimizuar rrezikun e votimit të dyfishtë apo falsifikimit të identitetit të zgjedhësit.²⁵ Përveç kësaj shenjat e gishtave mund të përdoren si provë në ankesa të mundshme pas-zgjedhore.²⁶ Të gjitha qendrat e votimit do të pajisen me një pajisje të veçantë që ndihmon në identifikimin e zgjedhësve dhe në skanimin e shenjave të gishtave. KQZ-ja planifikon të caktojë një operator teknik në çdo qendër votimi për të lehtësuar identifikimin e zgjedhësve. Sipas Ministrisë së Brendshme, janë rreth 800,000 zgjedhës me dokumente të pavlefshme identifikimi. Në muajin mars, Qeveria e shtyu vlefshmërinë e dokumenteve të identifikimit deri më 30 prill.

KQZ-së i mbetet ende të miratojë një metodologji gjithëpërfshirëse testimi, së bashku me politikat e rëndësishme të sigurisë për pajisjet dhe programet kompjuterike në këtë proces. Deri më sot, shumica e bashkëbiseduesve të MKVZ-së së ODIHR-it, duke përfshirë edhe secilën prej katër partive më të mëdha politike, kanë shprehur mbështetje për sistemin e regjistrimit elektronik të zgjedhësve.

²¹ MKVZ-ja e ODIHR-it është informuar se 2,861 votues mbi moshën 100 vjeç janë hequr nga regjistri i zgjedhësve, kurse 446 vazhdojnë të jenë në regjistrin përfundimtar të zgjedhësve.

²² Ata vazhdojnë të jenë në listë me adresën e regjistruar herën e fundit.

²³ Sipas DPGJC-së, ndryshimet e iniciuara në regjistri në adresat e zgjedhësve nuk rezultuan në ndryshim të qendrës së votimit të zgjedhësve, pasi ata vazhdojnë të mbeten në qendrat e tyre të zakonshme të votimit. Sipas ligjit, zgjedhësit njoftohen deri në 60 ditë pas publikimit të ekstraktit të listave të zgjedhësve.

²⁴ Sipas KQZ-së, duke qenë se ligji parashikon që zgjedhësi të paraqitet personalisht në QV, zgjedhësit që janë të infektuar me COVID-19 dhe që ndodhen në karantinë, inkurajohen të respektojnë rregullat e izolimit.

²⁵ Nëse do të jetë e nevojshme, do të përdoren listat fizike të zgjedhësve.

²⁶ Procesi i prokurimit për zgjidhjen e re të identifikimit elektronik të zgjedhësve u mbyll me 10 shkurt.

VII. PROPOZIMET DHE REGJISTRIMET E KANDIDATEVE

Çdo zgjedhës me të drejtë vote ka të drejtë të kandidojë, përveç atyre që vuajnë aktualisht një dënim me burg ose që kanë qenë të dënuar më parë për vepra penale specifike²⁷. Kushtetuta rendit kategoritë e zyrtarëve, veprimtaria e të cilëve është e papajtueshme me të drejtën për të kandiduar²⁸.

Lista kandidatësh mund të dorëzohen nga partitë politike dhe nga koalicionet e partive. Duhet të paraqitet një listë për secilën nga 12 zonat zgjedhore²⁹. Kandidati mund të paraqitet vetëm në një listë, megjithëse ndryshimet ligjore të 2020-ës parashikojnë një përjashtim nga ky rregull për kryetarët e partive, të cilët lejohen të kandidojnë në deri katër zona zgjedhore, por nëse zgjidhen, ata mund të mbajnë vetëm një mandat. Pas regjistrimit, renditja e kandidatëve në listë nuk mund të ndryshohet. Kandidatët e pavarur mund të garojnë përmes emërimit nga një grup zgjedhësish.³⁰

Në secilën listë, nga secila gjini duhet të emërohet të paktën një e treta e kandidatëve. Numri i kandidatëve në listë nuk mund të jetë më i vogël se numri i mandateve që i janë caktuar asaj zone zgjedhore dhe ky numër mund të rritet me deri dy mandate³¹. Kodi Zgjedhor është i paqartë në lidhje me limitin e sipërm të kandidatëve në listë. Më 18 mars, Komisioneri nuk e pranoi regjistrimin e 69 kandidatëve të emëruar nga koalicioni i PD-së Aleanca për Ndryshim në 12 zonat zgjedhore, me argumentin se këto emërimet tejkalonin kufirin e sipërm "të nënkuptuar". KAS-i e hodhi poshtë vendimin e Komisionerit; megjithatë, Kolegji Zgjedhor e la më pas në fuqi vendimin e Komisionerit më 30 mars, duke vendosur efektivisht një kufi të sipërm për listat.

Kandidaturat verifikohen nga KQZ-ja në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe me Ligjin e Dekriminalizimit³². Para regjistrimit përfundimtar të listave nga KQZ-ja, kandidatët e paraqitur që konstatohet se nuk e kanë të drejtën e kandidimit hiqen nga listat dhe KQZ-ja u jep mundësinë partive që t'i zëvendësojnë. Nëse, pas regjistrimit të listave, dalin informacione të reja që duhet të çojnë në skualifikimin e një kandidati, kandidati vazhdon të qëndrojë në listë, por nuk mund ta marrë mandatin nëse zgjidhet.³³ Procesi i skualifikimit dhe heqjes së mandatit është një proces që mund të ndodhë në çfarëdolloj momenti të ciklit zgjedhor.

Para afatit ligjor të 18 marsit, KQZ-ja kishte regjistruar 12 lista që konkurrojnë në të gjithë vendin dhe 5 kandidatë të pavarur që garojnë në 5 qarqe.³⁴ KQZ-ja refuzoi regjistrimin e një liste – listën e Aleancës

²⁷ Sipas Ligjit të Dekriminalizimit, shtetasit e dënuar për vepra të caktuara penale ose të deportuar, edhe në mungesë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, nga një Shtet Anëtar i BE-së, Australia, Kanadaja dhe Shtetet e Bashkuara nuk lejohen të kandidojnë në zgjedhje, ashtu si edhe shtetasit që janë objekt i një urdhri ndërkombëtar arresti.

²⁸ Gjykatësit, prokurorët, ushtarakët, policët dhe oficerët e sigurisë kombëtare, përfaqësuesit diplomatikë, kryetarët e bashkive, prefektët, kryetarët dhe anëtarët e komisioneve zgjedhore, Presidenti i Republikës, zyrtarët e lartë të administratës shtetërore të përcaktuara me ligj.

²⁹ Listat e kandidatëve duhet të mbështeten me firmat e 5,000 zgjedhësve për partitë ose 7,000 zgjedhësve për koalicionet në të gjithë vendin. Zgjedhësit mund të mbështesin disa lista njëherësh.

³⁰ Grupet e votuesve duhet të përbëhen nga të paktën nëntë zgjedhës dhe të regjistrohen në KQZ për të mbledhur firmat e një përqind të zgjedhësve në zonën zgjedhore përkatëse, por jo më shumë se 3,000.

³¹ Rritja me deri në dy mandate bëhet për të garantuar që në të gjitha rrethanat, numri i kandidatëve të nominuar në listë të jetë i pjesëtueshëm me pjesëtuesin tre në mënyrë që të llogaritet kuota gjinore.

³² Secili kandidat duhet të paraqesë një formular vetëdeklarimi mes dokumenteve të tjera në mbështetje të kandidaturës së tyre. Procesi i verifikimit nga KQZ-ja kryhet në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve (Zyra e Gjendjes Gjyqësore) dhe Zyra e Gjendjes Civile. Procedurat rregullohen me Ligjin e Dekriminalizimit, një akt nënligjor i Kuvendit, si dhe me udhëzimet e Komisionerit.

³³ KQZ-ja mund t'i dërgojë emrat e kandidatëve të prekur në Prokurorinë e Përgjithshme (PP) për hetime të mëtejshme. 28 kandidatë gjithsej, nga 9 lista tashmë të miratuara janë dërguar në PP deri më 3 prill; këtu përfshihen kandidatë nga listat e PS-së, PD-së, PSD-së dhe nga listat e partive të tjera.

³⁴ Pesë kandidatët e pavarur do të garojnë në Dibër, Gjirokastrë, Lezhë, Shkodër dhe Tiranë.

për Ndryshim - me arsyetimin se disa parti kishin dalë nga koalicioni që përpara se të përfundonte regjistrimi (shih Ankesat dhe Apelimet).³⁵

VIII. MJEDISI ZGJEDHOR DHE FINANCIMI I FUSHATËS

Sipas Kodit Zgjedhor, fushata zgjedhore fillon zyrtarisht 30 ditë para ditës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 orë para ditës së zgjedhjeve. Dy partitë më të mëdha i filluan fushatat më 25 mars. Fillimi i fushatës u zhvillua në kushtet e kufizimeve të vendosura si pasojë e pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, të cilat përfshinë edhe kufizimet e tubimeve dhe ruajtjen e distancimit personal.³⁶ Kjo situatë solli sfida nga pikëpamja logjistike për organizatorët e të dyja këtyre eventeve.³⁷ Kryesia e PS-së dhe ajo e PD-së e informuan MKVZ-në e ODIHR-it mbi synimet e tyre për të respektuar protokollin e COVID-19 gjatë fushatës, si dhe për mënyrën e organizimit të fushatës, e cila do të konsistonte në fushatën derë-më-derë, duke përdorur si qasjen tradicionale, ashtu edhe mediat sociale. Disa parti ishin të mendimit se kufizimet ndaj organizimit të fushatave të mëdha dhe mbështetja tek kontaktet direkte me njerëzit, të cilat kushtojnë më pak, i vendosin partitë e vogla politike në një pozicion më të barabartë me partitë e mëdha.

Në fillimet e saj, kjo fushatë u karakterizua nga një ton jo i moderuar i përdorur prej udhëheqësve kryesorë të partive politike. Akuzat e ngritura për korrupsion dhe për lidhje me krimin e organizuar janë shndërruar në një lloj mesazhi kyç të fushatës zgjedhore. Komisioneri u ka bërë thirrje partive që të tregohen të vetëpërmbytura dhe të mos përdorin gjuhë të ashpër gjatë fushatës.³⁸ Një prej tri partive politike kryesore drejtohet nga një grua. Në dy partitë e tjera të mëdha, të cilat drejtohen nga kryetarë burra, janë vënë re përpjekje për të rritur vizibilitetin e rolit të gruas.³⁹

Ndryshimet e fundit u shoqëruan me garanci të mëtejshme kundër shpërdorimit të burimeve shtetërore. Kështu, katër muaj para ditës së zgjedhjeve, autoritetet nuk mund të miratojnë rregullore që ofrojnë përfitime të shtuara për asnjë pjesë të popullsisë. Përveç kësaj, KQZ-ja është e autorizuar të shqyrtojë të gjitha organizimet e mbajtura nga institucionet publike për të parë nëse ka pasur shpërdorime të burimeve publike. Më 24 mars, Komisioneri i shkruajti të gjitha ministrive, si dhe të gjitha bashkive, duke u bërë thirrje drejtuesve të institucioneve publike që të tregoheshin të vetëpërmbytur dhe të përmbushnin detyrimet e tyre në lidhje me ndalimin e përdorimit të burimeve shtetërore në mbështetje të subjekteve zgjedhore. KQZ-ja ka dërguar 64 persona si staf mbështetës në qarqe për të monitoruar respektimin e rregullave të fushatës nga subjektet zgjedhore.

Partitë politike që kanë konkurruar në zgjedhjet e fundit parlamentare marrin fonde publike për aktivitetet e tyre të zakonshme.⁴⁰ Përveç kësaj, partitë që kanë fituar të paktën 1% të votave në zgjedhjet e fundit parlamentare, marrin fonde publike për fushatën zgjedhore, në raport të drejtë me numrin e

³⁵ Koalicioni Aleanca bëri ankim për mosregjistrimin në KAS dhe më pas në Kolegjin Zgjedhor.

³⁶ Kufizimet e përkohshme lejojnë grumbullime të një maksimumi prej 10 personash sipas Urdhrit Nr. 633/2020 të Ministrisë të Shëndetësisë. Ky urdhër u konfirmua nga Gjykata Kushtetuese, e cila sidoqoftë shprehu një rezervë në lidhje me afatin e pacaktuar të masave të vendosura.

³⁷ PS-ja e filloi fushatën pa praninë e mbështetësve dhe e organizoi takimin duke marrë masat për ruajtjen e distancimit përmes mënyrës së vendosjes së karrigeve gjatë takimit. Në hapjen e fushatës së PD-së, e cila ishte konceptuar si një grumbullim makinash, qindra mbështetës, shumë prej të cilëve nuk e respektuan protokollin e COVID-19, u vendosën lirisht para skenës dhe rreth sheshit.

³⁸ Referoju [deklaratës për shtyp të KQZ-së të datës 19 mars 2021](#).

³⁹ Në hapjen e fushatës së PS-së, 11 nga 14 fjalime gjithsej u mbajtën nga [kandidate gra](#): Po ashtu, edhe drejtuesi i PD-së theksoi rolin kyç që luajnë gratë në politikë.

⁴⁰ Fondi i buxhetit për 2021-shin është 140 milion lekë (afërsisht 1,138,000 Euro). Bazuar tek rezultatet e zgjedhjeve parlamentare të 2017, 6 partive ju caktua një fond prej: PS – 45.3 për qind, PD – 27.8 për qind, LSI – 14.3 për qind, PDIU – 5.3 për qind, PSD – 3.8 për qind dhe LIBRA – 3.5 për qind.

votave të marra.⁴¹ Kandidatët e pavarur nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga fondet publike. Subjektet zgjedhore mund t'i financojnë fushatat e tyre edhe me fondet e veta, me donacione nga shtetas shqiptarë, persona juridikë apo kredi bankare⁴². Dhurimet, duke përfshirë dhe ato jomonetare, kanë një kufizim prej 1 milion lekësh (afërsisht 8,130 Euro).⁴³

Kontributet mbi 50,000 lekë (afërsisht 406 Euro) duhet të kryhen përmes një llogarie bankare të caktuar për këtë qëllim. Shpenzimet totale të fushatës së një partie nuk duhet të tejkalojnë vlerën prej 167,480,000 lekësh (afërsisht 1,361,000 Euro); shpenzimet e kandidatëve të pavarur nuk duhet të kalojnë vlerën prej 27,913,000 lekësh (afërsisht 131,000 Euro). Çdo subjekt zgjedhor duhet të regjistrojë shumën e dhurimeve të marra, si dhe të dhënat për identifikimin e dhuruesit, në një regjistër të posaçëm të miratuar nga KQZ-ja. Të gjitha shpenzimet e fushatës duhet të dokumentohen dhe të raportohen në përputhje me rregullat fiskale. Ligji nuk përmban ndonjë parashikim që t'i detyrojë subjektet zgjedhore të bëjnë publik burimin dhe shumën e fondeve të mbledhura para ditës së zgjedhjeve.

Sipas ligjit, KQZ-ja mbikëqyr respektimin e rregullave të financimit të fushatës. KQZ-ja është e autorizuar të vendosë sanksione në rast papajtueshmërie me rregullat përkatëse. Subjektet zgjedhore janë të detyruara të paraqesin raportet financiare brenda 60 ditëve nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve. Brenda pesë ditësh nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve, KQZ-ja duhet të caktojë auditues për vlerësimin e këtyre raporteve. Gjetjet e audituesve duhet të publikohen brenda 30 ditësh nga data e dorëzimit të tyre. Partive nuk u kërkohet të bëjnë raportime të ndërmjetme.

IX. MEDIA

Mjedisi mediatik është i larmishëm dhe përfshin një numër të lartë subjektsh mediatike. Televizioni (TV) mbetet burimi kryesor i informimit politik, pasuar nga mediat online dhe rrjetet sociale. Disa bashkëbisedues të MKVZ-së së ODIHR-it shprehën shqetësimin se subjektet mediatike shërbejnë shpesh si platforma lobuese për vetë pronarët e tyre, duke sfiduar kështu pavarësinë e tyre editoriale dhe duke nxitur autocensurën. Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias (RFoM) ka ngritur shqetësimet lidhur me intimidimin dhe sulmet ndaj gazetarëve, gjë që minon sigurinë e tyre.⁴⁴

Kushtetuta parashikon lirinë e shprehjes, lirinë e medias dhe të drejtën për informim, ndërkohë që ndalon censurimin e mjeteve të komunikimit. Shpifja vazhdon të përbëjë vepër penale, por megjithatë, dënohet vetëm me gjobë.⁴⁵ Veprimtaria e medias audiovizive jashtë periudhës zgjedhore rregullohet nga Ligji për Median Audiovizive, ndërsa media e shkruar është më së shumti e vetërregulluar.

Pasqyrimi i fushatës në mediat audio-vizive rregullohet hollësisht nga Kodi Zgjedhor, i cili parashikon qasje në edicionet e lajmeve dhe në programet informative të këtyre mediave⁴⁶ për të gjitha subjektet

⁴¹ PS mori rreth 55,8 milion lekë; PD - 31,5 milion lekë; LSI - 18,9 milion lekë; PDIU - 4,5 milion lekë; FRD - 2,1 milion lekë; PR - 1,8 milion lekë; PSD - 1,6 milion lekë; Bindja Demokratike - 1,4 milion lekë; Partia Kristian Demokratike - 1,4 milion lekë, dhe Lëvizja për Zhvillimin Kombëtar - 1,4 milion lekë. Pragu i një për qind të votave në zgjedhjet e fundit u prezantua në vitin 2020. Para ndryshimit, të gjitha partitë që garonin në zgjedhje kishin të drejtë të merrnin fonde publike për fushatën e tyre.

⁴² Nuk lejohen dhurimet nga personat juridikë që kanë marrë fonde me prokurim publik që e tejkalojnë shumën prej 10 milionë lekësh (afërsisht 81,000 Euro), që kanë qenë pjesë të projekteve të partneritetit publik-privat, që kanë detyrime ndaj buxhetit të shtetit, si dhe ato që zhvillojnë aktivitet mediatik.

⁴³ 1 Euro është afërsisht e barabartë me 123 lek.

⁴⁴ Shih deklaratën e [RFoM](#) dhënë më 23 shkurt 2021.

⁴⁵ Neni 120 i Kodit Penal parashikon që gjoba për shpifje varion nga 50,000 lekë (rreth 400 Euro) deri në 3,000,000 lekë (afërsisht 24,000 Euro).

⁴⁶ Transmetuesve u kërkohet që t'u ofrojnë minutazh të barabartë për pasqyrim të fushatës, partive që kanë më shumë se 20 për qind të vendeve në Kuvend. Çdo partie tjetër parlamentare i jepet gjysma e kësaj kohe, ndërsa minutazhi i mbulimit për partitë joparlamentare që garojnë në zgjedhje është në diskrecion të redaktorëve dhe nuk mund të tejkalojë atë të partive parlamentare.

zgjedhore. Këtu përfshihen edhe mundësitë e fushatës pa pagesë në televizionin publik dhe reklamat me pagesë në transmetuesit privatë. Ligji thotë se pasqyrimi i promovimit të arritjeve të institucioneve publike, si për shembull inaugurimi i punëve publike, konsiderohet i lidhur me qëllimet elektorale dhe llogaritet në kohën e transmetimit të partisë, së cilës i përket titullari i institucionit përkatës. Ligji akoma lejon përdorimin e materialeve të vëna në dispozicion nga subjektet zgjedhore në edicionet e lajmeve, nëse ato identifikohen qartë si të tilla.

Më 23 mars, në përputhje me ligjin, KQZ-ja përcaktoi vendosjen e kohës falas në dispozicion të fushatës nga Radio Televizioni Publik Shqiptar (RTSH)⁴⁷. Shorteu për përcaktimin e datës dhe të radhës së paraqitjes për reklamat politike pa pagesë u mbajt në RTSH më datë 30 mars. Ndonëse sipas ligjit, shorteu duhej mbajtur nën mbikqyrjen e KQZ-së, asnjë prej përfaqësuesve të institucionit nuk mori pjesë në të. Kodi Zgjedhor e kufizon minutazhin me pagesë në çdo stacion televiziv gjatë gjithë kohëzgjatjes së fushatës në 90 minuta për secilin subjekt zgjedhor dhe në 10 minuta për partitë joparlamentare dhe kandidatët e pavarur⁴⁸. Megjithëse ligji kërkon që transmetuesit privatë të dorëzojnë listat e tarifave në KQZ pesë ditë para nisjes së fushatës, tre nga njëmbëdhjetë subjekte mediatike gjithsej e bënë këtë pas kalimit të afatit. Një prej stacioneve televizive ka ofruar edhe shërbime me pagesë si transmetime *live*, intervista dhe pjesëmarrje në programe ose debate politike.

Në vijim të ndryshimeve të fundit, Autoriteti i Mediave Audio-Vizuale (AMA) është tashmë përgjegjës për monitorimin e respektimit të detyrimeve ligjore nga ana e mediave⁴⁹. AMA nisi monitorimin e më shumë se 30 transmetuesve që më 26 mars. Raportimet ditore të monitorimit, të publikuara në faqen zyrtare të KQZ-së, përfshijnë detaje të tilla si minutazhi që u jepet subjekteve zgjedhore në zgjedhje dhe aktorëve të tjerë politikë në të gjitha programet, rendi i shfaqjes së tyre në lajme, raporti gjinor në të gjitha subjektet e monitoruara dhe përfundimet mbi performancën e subjektit mediatik në lidhje me përmbushjen e kërkesave profesionale dhe ligjore. Raporte të tjera mundet që të përmbajnë gjithashtu edhe propozime për sanksione.⁵⁰ AMA nuk analizon tonin e mbulimit.

Më 26 mars, MKVZ/ja e ODIHR-it, nisi monitorimin sasior dhe cilësor të pesë kanaleve televizive dhe të dy subjekteve mediatike online⁵¹. Misioni po ndjek edhe përmbajtjet e lidhura me zgjedhjet në rrjetet sociale.

⁴⁷ Aleancës për Ndryshim të Partisë Demokratike dhe Partisë Socialiste iu vunë në dispozicion 90 minuta pa pagesë; Partisë Socialdemokrate dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim iu vunë në dispozicion 45 minuta, ndërsa secilës prej partive joparlamentare që garojnë në zgjedhje dhe koalicionit ABEOK iu dhanë 20 minuta. Kandidatëve të pavarur iu vunë në dispozicion 10 minuta. Shorti i parë u hodh në RTSH më 1 prill.

⁴⁸ Përveç minutazhit të blerë për reklamë nga ana e subjekteve zgjedhore, transmetuesit do të ofrojnë falas gjysmën e kohës totale të paguar.

⁴⁹ Shtatë anëtarët e AMA-s emërohen nga parlamenti për një mandat 5-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Aktualisht, në këtë institucion janë tre vende vakante, ndërkohë që mandatet e kryetarit dhe të një anëtari kanë përfunduar. Sipas [faqes](#) zyrtare të parlamentit, deri në afatin zyrtar që ishte në shkurt 2020, nuk ka pasur një numër të mjaftueshëm aplikantësh që kanë shprehur interes për pozicionin e kryetarit.

⁵⁰ Kodi Zgjedhor parashikon gjoba prej deri në 500,000 lekë (rreth 28,500 Euro) për shkeljen e balancës së minutazhit që u jepet subjekteve zgjedhore, si dhe për moszbatimin e kriterëve profesionale në përmbajtjen e programeve të informimit dhe edicioneve të lajmeve. Paga e gjobës është e detyrueshme pavarësisht apelimit të vendimit. Penaliteti për shkelje të përsëritura mund të rezultojë në ndërprerjen e transmetimit për 48 orë.

⁵¹ Transmetuesi publik RTSH 1 dhe katër kanalet private televizive: *Top Channel*, *TV Klan*, *Vizion Plus* dhe *A2 CNN*. Përmbajtjen e lidhur me zgjedhjet të dy faqeve lajmesh online <http://www.panorama.com.al/> dhe <https://www.oranews.tv/>,

X. ANKIMI DHE APELIMI

Ndaj vendimeve të Komisionerit dhe të KZAZ-ve mund të bëhet ankesë tek organi i ri i sapokrijuar i KQZ-së, Komisioni i Ankesave dhe Sanksioneve (KAS).⁵² Si rregull, ankesat depozitohen nga subjektet zgjedhore, të cilave u janë prekur interesat, brenda tri ditësh nga dhënia e vendimit.⁵³ Ankimimet lidhur me rezultatin e zgjedhjeve mund të dorëzohen brenda pesë ditëve. Vëzhguesit kanë të drejtë të ankimojnë vetëm refuzimin e akreditimit, kurse zgjedhësve nuk u lejohet të bëjnë ankim, përveçse lidhur me përfshirjen e tyre në listën e zgjedhësve. Ligji nuk shprehet qartë për gjykimin e ankesave në komisionet e niveleve më të ulëta, duke sjellë⁵⁴ paqartësi se cili është organi përgjegjës për ankesat lidhur me shkeljet gjatë fushatës dhe për mosrespektim të procedurave në ditën e zgjedhjeve.

Vendimet e KQZ-së mund të ankimohen brenda pesë ditësh në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit të Tiranës, i cili është organi më i lartë gjyqësor për çështjet e zgjedhore.⁵⁵ Kolegji Zgjedhor ka dhjetë ditë kohë për të dalë me një vendim që nga momenti i dorëzimit të ankimit. Më 26 mars, Komisioneri kërkoi formalisht një proces shqyrtimi të përshpejtuar për regjistrimin e kandidatëve, pasi afati dhjetë-ditor mund të krijonte konflikt me afatin për prodhimin dhe shpërndarjen e fletëve të votimit.

Që prej 5 prillit, në KAS janë depozituar dhjetë ankesa.⁵⁶ Kolegji Zgjedhor ka shqyrtuar tre ankime.⁵⁷ Procedura e ankimit administrativ e parashikuar nga Kodi Zgjedhor është një procedurë e hollësishme dhe i ka garancitë për një proces të rregullt ligjor. Ankimimet që nuk i përmbushin të gjitha kërkesat mund të ridorëzohen të plotësuara brenda një afati 24-orësh.

XI. PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE

Kushtetuta e Shqipërisë parashikon të drejta të plota politike, civile dhe sociale për personat që u përkasin pakicave kombëtare. Në Shqipëri janë nëntë pakica kombëtare të njohura zyrtarisht.⁵⁸ Sipas të dhënave të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, më pak se 1.5 për qind e popullsisë i përket një pakice kombëtare.⁵⁹ Në zgjedhjet e kaluara, vetëm pakica kombëtare greke arriti të marrë një vend në parlament

⁵² KAS përbëhet nga pesë anëtarë të zgjedhur nga parlamenti për një mandat nëntë-vjeçar nga radhët e ish-gjyqtarëve, këshilltarëve të gjykatave më të larta, anëtarëve të KQZ-së, zyrtarëve të lartë ose ekspertëve me përvojë në gjykimin administrativ.

⁵³ Ankesat dhe ankimimet mund të paraqiten edhe përmes një formulari elektronik në faqen zyrtare të KQZ-së.

⁵⁴ Dyzet ditë para dhe deri 24 orë para ditës së zgjedhjeve, çdo ankesë në lidhje me pasaktësitë në listat e zgjedhësve duhet të paraqitet në gjykatat e rretheve.

⁵⁵ Kolegji Zgjedhor përbëhet nga tetë gjyqtarë, pesë prej të cilëve janë gra, nga gjykatat e shkallës së parë dhe ato të apelit, të zgjedhura përmes një shorti dhe të emëruara për një mandat katër-vjeçar më 9 dhjetor 2020. Çështjet shqyrtohen nga një panel prej pesë gjyqtarësh.

⁵⁶ Dy kanë të bëjnë me regjistrimin e kandidatëve, një pretendim se KQZ përjashtoi padrejtësisht partinë nga marrja e fondeve publike, tre ishin në lidhje me keqpërdorimin e burimeve publike, tre lidhur me konfigurimin e fletëve të votimit dhe një në lidhje me përbërjen e grupeve të numërimit.

⁵⁷ Më 29 mars, Kolegji Zgjedhor rrëzoi vendimin e KAS-it mbi ankesën e PD - Aleanca për Ndryshim - në lidhje me kufirin e sipërm të numrit të kandidatëve në një listë, dhe më 31 mars ajo refuzoi ankesën e Koalicionit Aleanca mbi mospranimin e KQZ-së për të regjistruar listën (shih Emërimi dhe Regjistrimi i Kandidatëve). Më 4 prill, Kolegji Zgjedhor gjykoi një ankimim nga PD në lidhje me logon e Partisë së Bindjes Demokratike, ku përmbysi pjesërisht një vendim të mëparshëm të KAS-it, duke i dhënë efekt juridik vendimit të Komisionerit për hartimin e fletës së votimit.

⁵⁸ Ligji nr. 96/2017, në fuqi që prej 24 nëntorit 2017, njeh pakicat kombëtare arumune, boshnjake, bullgare, egjiptiane, greke, maqedonase, malazeze, rome dhe serbe.

⁵⁹ Një tjetër regjistrim i popullsisë që ishte parashikuar fillimisht të kryhej në vitin 2020, planifikohet tashmë të bëhet në vitin 2021.

përmes një partie pakice kombëtare, megjithëse ka edhe individë, pjesë të pakicave kombëtare, që kanë fituar mandate në parlament përmes përfaqësimit të partive të mëdha.⁶⁰

KQZ-ja, përmes mbështetjes së organizatave ndërkombëtare, po i përkthen procedurat e votimit në gjuhët e pakicave kombëtare, ashtu sikurse edhe në gjuhën e shenjave. Posterat për identifikimin e votuesve dhe për specifikimin e krimeve zgjedhore në gjuhët e pakicave kombëtare, janë tashmë të disponueshme në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së.

Disa bashkëbisedues të MKVZ-së së ODIHR-it kanë vënë në dukje se tentativat për blerje votash mund të mbeten ende problem në komunitetet e varfra nga ana ekonomike dhe sociale, duke përfshirë edhe zonat me popullsi të lartë të pakicës rome.

XII. VËZHGESIT VENDORË DHE NDËRKOMBËTARË

Kodi Zgjedhor parashikon vëzhgimin e zgjedhjeve nga vëzhgues vendas dhe vëzhgues ndërkombëtarë në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore. Partitë parlamentare dhe koalicionet mund të caktojnë përfaqësues të përhershëm në KQZ, kurse partitë e tjera kanë të drejtë të caktojnë përfaqësues në KQZ vetëm gjatë periudhave zgjedhore. Të gjitha subjektet zgjedhorë kanë të drejtë të caktojnë vëzhgues në KZAZ, KQV dhe në QNV-të përkatëse.⁶¹ E drejta për të caktuar vëzhgues në rastin e koalicioneve i takon vetëm koalicionit dhe jo partive përbërëse të tij.

Procesi zgjedhor ndiqet nga organizata të ndryshme vendase, të cilat fokusohen në aspekte të ndryshme, ku përfshihet shpërdorimi i burimeve publike, performanca e administratës zgjedhore dhe financimi i fushatës. Që prej 3 prillit, KQZ-ja ka regjistruar tetë grupe vëzhguesish vendorë.

XIII. AKTIVITETET E MKVZ-SË SË OSBE/ODIHR-IT

MKVZ-ja e ODIHR-it e nisi aktivitetin më 19 mars në Tiranë, me një konferencë për shtyp. Kreu i Misionit ka zhvilluar takime me autoritetet qeveritare, me KQZ-në, me përfaqësues të partive politike, median, përfaqësues të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, si dhe me komunitetin ndërkombëtar.⁶² Asambleja Parlamentare e OSBE-së dhe Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës kanë bërë të ditur se do të dërgojnë delegacione vëzhguesish në ditën e zgjedhjeve. Kryetari i Rashës i OSBE-së ka emëruar z. Azay Guliyev si Kryetar dhe Koordinator të Posaçëm të Misionit afatshkurtër të Vëzhgimit të këtyre Zgjedhjeve nga OSBE-ja.

*Versioni anglisht i këtij raporti është i vetmi dokument zyrtar.
Një përkthim jozyrtar është i disponueshëm në gjuhën shqipe.*

⁶⁰ Partia e Bashkimit të të Drejtave të Njeriut (PBDNJ), e cila përfaqëson gjerësisht pakicat kombëtare greke, fitoi një mandat në zgjedhjet parlamentare të vitit 2009.

⁶¹ Organizatat e vëzhguesve vendorë dhe partitë politike që garojnë në zgjedhje kanë të drejtë të caktojnë një vëzhgues për KZAZ, KQV dhe tryezë numërimi. Koalicionet kufizohen në tre vëzhgues për KZAZ, KQV dhe tryezë numërimi.

⁶² MKVZ-ja e ODIHR-it dhe Prezenca e OSBE-së në Shqipëri operojnë të ndara, secila sipas mandatit të vet.